

SHËNIM SHPJEGUES – SKK 11

Shënime shpjeguese për Standardet e Kontabilitetit të Kosovës kanë për qëllim të japin informacion shtesë për Standardet dhe udhëzime teknike për sa i përket përdorimit dhe zbatimit të tyre. Në rast të ndonjë divergjence ndërmjet Shënimeve Shpjeguese dhe Standardeve, janë Standardet ato që mbizotërojnë

1. Si pjesë e operimeve normale të biznesit , ndërmarrjet në Kosovë mund të hyjnë në transaksione që janë të emëtuara në valuta të huaja. Të emëtuara në valutë të huaj do të thotë se pagesa kërkohet që të bëhet apo të pranohet në valutë të huaj. Një ndërmarrje që hyn në një transakcion të emëruar në valutë të huaj e merr parasysh rrezikun e shkallëve (normave) të këmbimit. Rreziku i normës së këmbimit është mundësia se do të ndryshojw norma e këmbimit e valutës së huaj gjatë operimeve lokale dhe raportimeve të valutës së ndërmarrjes. Rreziku mund të rezultojë në këmbimin e fitimeve apo humbjeve përkitazi me valutën e huaj. Këmbimet e fitimeve dhe humbjeve të valutës së huaj njihen në pasqyrën e të ardhurave të ndërmarrjes raportuese.
2. Transaksionet e valutës së huaj janë aktivitetet e emëtuara në apo që kërkojnë rregullim në valutën e huaj. Shembuj të aktiviteteve të zakonshme në valutë të huaj nga një ndërmarrje përfshijnë:
 - ? Të qenit palë ndaj kontratave të këmbimeve në valutë të huaj
 - ? Marrja apo heqja nga përdorimi i pasurive që janë të emëruara në valutë të huaj
 - ? Paraqitja apo rregullimi i detyrimeve që nuk janë të emëruara në valutë të huaj
3. Llojet më të zakonshme të transaksioneve në valutë të huaj nga një ndërmarrje janë:
 - ? Blerja apo shitja e mallrave me çmime që janë të emëruara në valutë të huaj
 - ? Huazimi apo dhënia hua e parave në të cilat shumat e pagueshme apo të pranueshme janë të emëruara në valutë të huaj
4. Në mënyrë që të përfshijmë këto aktivitete në pasqyrat financiare të entiteteve raportuese, SKK 11 “Efektet e ndryshimeve në normat e këmbimit në valutë të huaj” na jep udhëzime në kontabilitetin mbi aktivitetet që nuk janë të transaktuara në valutën e huaj.

Ilustrim i transaksionit në valutë të huaj – Blerja e mallërave

Shitësi: Koorporata e SHBA-ve
Blerësi: Kompania e importeve të Kosovës

Data e shitjes: 1/12/X1

Përshkrimi: 1,000 palë xhinsa
Çmimi i blerjes: USD \$10,000

Blerësi, Importet e Kosovës, do t'i regjistrojë të pagueshmet duke përdorur kostot ekuivalente në euro. Kjo është shumën e eurove që kërkohen në mënyrë që të këmbëjmë për 10,000 \$ në datën e transakcionit të blerjes.

Ilustrim i Transakcioneve të valutës së huaj – Transakcion i huazimit

Debitori: Kompania e Importeve të Kosovës
Huazuesi: Banka e SHBA

Data e huasë: 1/12/X1
Shuma e huasë: 100,000 \$

Huazuesi, Importet e Kosovës, do të regjistrojë shënimin për detyrimin e pagueshëm duke përdorur shumat e ekuivalente në euro.

Regjistrimi fillestar

5. Transakcioni në valutë të huaj duhet fillimisht të regjistrohet në shkallën e këmbimit që është në fuqi me rastin e datës së transakcionit. Kjo quhet shkalla e aty për atyshme (mentale). Nëse kjo është më praktike, një shkallë e ponderuar mesatare javore apo mujore mund të përdoret nëse është përafërsim i mirë i shkallëve aktuale që janë në fuqi për periudhën. Një shkallë e ponderuar mesatare zakonisht përdoret kur ndërmarra ka një vëllim të madh të transakcioneve që janë të emëruara në valutë të huaj. Shkalla e ponderuar mesatare NUK DUHET të përdoret nëse shkallët e këmbimit ndryshojnë në mënyrë të dukshme gjatë periudhës raportuese.

6. Më poshtë është një ilustrim i regjistrimit fillestar të transakcioneve në valutë të huaj.

Shitësi: Koorporata e SHBA
Blerësi: Kompania e Importeve të Kosovës

Data e shitjes: 1/12/X1
Përshkrimi: 1,000 palë xhinsa
Çmimi i blerjes: USD \$10,000

Blerësi, Importet e Kosovës, blen xhinsa prej Koorporatës së SHBA-ve dhe i rishet ato në Kosovë. Importet e Kosovës do të regjistrojnë të pagueshmen duke përdorur koston ekuivalente në euro. Ajo është shuma e eurove që kërkohet në mënyrë që të këmbëhen për 10,000 \$ me datën e transakcionit blerës.

Shkalla e këmbimit, apo shkalla e mentale apo shkalla e aty për atyshme më 1/12/X1 është USD \$1: 1.1 euro. Një dollar amerikan do të pranohet për çdo 1.1

euro që janë të këmbyera, apo thënë ndryshe, 1.1 euro kërkohen që të blehen një dollar amerikan.

Importet e Kosovës do ta regjistrojnë blerjen me sa vijon:

Debia	Stoqet	11,000
Kredia	Kontot e pagueshme	11,000

Pasi që Importet e Kosovës duhet të mirëmbajnë kontot e tyre financiare në valutën e tyre të raportimit, të gjitha transaksionet duhet të regjistrohen në euro. Balanci i kontove të pagueshme prej 11,000 eurove është shuma e valutës së domosdoshme në mënyrë që të paguhet detyrimi prej \$10,000 amerikan.

Raportimi në pasqyrën e bilancit

7. Në pasqyrën e bilancit, korigjimet mund të jenë të domosdoshme për bilancet e regjistruara fillimisht të transaksioneve të emëruara në valutën e huaj. Përpunimi i raportimit dhe i kontabilitetit varet nga ajo nëse zërat janë monetarë apo jo monetarë. Zërat monetarë janë para të gatshme, kërkon që të pranojë një shumë fikse të parave të gatshme, dhe obligimeve që të paguajnë një shumë fikse të parave të gatshme. Zërat monetarë duhet të raportohen në pasqyrën e bilancit duke përdorur shkallën e aty për atyshme apo momentale me datën e pasqyrës së bilancit.

Pasuritë monetare

8. Shembuj të pasurive monetare:
 - ? Paratë e gatshme
 - ? Kontot e pranueshme
 - ? Shënimet e të pranueshme
 - ? Huatë e pranueshme

Detyrimet monetare

9. Shembuj të detyrimeve monetare janë:
 - ? Dividendat në para të gatshme të pagueshme
 - ? Kontot e pagueshme
 - ? Huatë e pagueshme
 - ? Shpenzimet e mbledhura të pagueshme në para të gatshme

Ilustrim i zërave monetarë

10. Në vijim është një ilustrim i kontabilitetit për bilancet e transaksioneve monetare në pasqyrën e bilancit.

Importet e Kosovës fillimisht e kanë regjistruar një të pagueshme duke përdorur koston në euro. Balanci i të pagueshmeve është shuma e eurove që kërkohet që të këmbehen USD\$10,000 me datën e transaksionit të blerjes. Shkalla e

këmbimit 1/12/X1, data e blerjes, ishte USD\$1: 1.1 euro. Shkalla e këmbimit më 31/12/X1, data e pasqyrës së bilancit, është USD\$1: 1.15 euro.

Blerja fillestare është regjistruar me sa vijon në euro:

Debia	Stoqet	11,000
Kredia	Kontot e pagueshme	11,000

Në datën e pasqyrës së bilancit më 31/12/X1, Importet e Kosovës do të raportojnë një bilanc të kontos së pagueshme prej 11,500 eurove që kanë të bëjnë me këtë zë. Pra është shuma e eurove që kërkohet me 31/12/X1 në mënyrë që të paguhet detyrimi prej USD\$10,000.

Zërat monetarë duhet të raportohen në pasqyrën e bilancit duke përdorur shkallën e aty për atyshme (mentale) me datën e pasqyrës së bilancit, kështu që bilanci i kontove të pagueshme duhet të korigjohet. Transaksionet e domosdoshme në mënyrë që të korigjoj pasqyrën e bilancit zërat monetarë të pasqyrës së bilancit për ndryshimet në shkallën e aty për atyshme do të diskutohen në seksionin e mëtejshëm të Shënimit Shpjegues.

Zërat jo monetarë

11. Zërat jo monetarë janë zërat që nuk kërkojnë faturë të pranimit apo pagesë në para të gatshme apo diçka ekuivalente. Shembuj të zërave jo monetarë janë:

- ? Pasuritë fikse
- ? Pasuritë e paprekshme
- ? Amortizimi i mbledhur në pasuritë fikse
- ? Investimet në aksione
- ? Stoqet

Bilancet e zërave jo monetarë janë të korigjuara për ndryshimet në shkallën e aty për atyshme.

Identifikimi i zërave monetarë dhe jo monetarë

12. Është me rëndësi që në mënyrë të duhur ti klasifikojmë si monetarë dhe jo monetarë për transaksionet e huaja për qëllime të kontabilitetit në mënyrë që ti regjistrojmë në mënyrë të duhur dhe raportojmë aktivitetin.

Zërat monetarë përfshijnë paratë e gatshme dhe të drejtën fikse për të pranuar apo obligimin për të paguar një shumë fikse të parave të gatshme apo në ekuivalentë.

Monetarë	Jo monetarë	Kërkon analiza¹
Paratë e gatshme dhe bilancet	Investimet në aksione	Shpenzimet e parapaguara
Valuta e huaj	Stoqet	Të hyrat e vonuara
Investimet në bona	Pasuritë fikse	
Kontot e pranueshme	Amortizimi i mbledhur	
Shënimet e të pranueshmeve		
Të pranueshmet e tjera	Pasuritë e tjera	
parapagimet për furnitorët	Pasuritë e paprekshme	
Huatë për drejtorët dhe punëtorët		
Kontot e pagueshme		
Dividendat në para të gatshme të pagueshme		
Parapagimet nga konsumatorët		
Shënimet dhe bonat e pagueshëm		
Borxhet e tjera afatgjatë		

¹ Disa zëra në pasqyrën e bilancit kërkojnë analiza. Kjo është për arsye se komponentat e kontos do të ndryshojnë prej njëres ndërmarrje në tjetrën, apo që edhe zërat monetarë dhe ata jo monetarë do të përzihen në të njëjtën konto. Shpenzimet e parapaguara duhet të analizohen që të përcaktohet nëse pasuria do të pranohet në para të gatshme, cila është një pasuri monetare, apo si një shërbim, cila është pasuri jo monetare. Të hyrat e vonuara kërkojnë analiza në mënyrë që të përcaktojnë nëse detyrimi do të përmbushet me pagesën apo me ndonjë mënyrë tjetër. Për shembull, nëse të hyrat e vonuara janë rezultat i pagesave të sigurimit të pranuar nga një kompani e sigurimeve, është një zë jo monetar sepse detyrimi do të kryhet kur të jenë kryer shërbimet. Paratë e gatshme nuk kërkohen në mënyrë që të rregullohet detyrimi.

Raportimi i zërave jo monetar

13. Trajtimi i shumicës së zërave jo monetarë është që t'i raportojmë ato duke përdorur shkallën e këmbimit prej datës së transakcionit. Ky është një trajtim i duhur për zërat jo monetarë që barten në koston historike.

14. Në vijim e keni një ilustrim të balanceve të transaksionit jo monetar në pasqyrën e bilancit kur zëri është raportuar në koston historike.

Importet e Kosovës fillimisht e kanë regjistruar një blerje të stoqeve duke përdorur një kosto ekuivalente në euro. Është shuma e eurove që kërkohet në mënyrë që të këmbejmë për USD\$10,000 në datën e transakcionit blerës. Shkalla e këmbimit më 1/12/X1, data e blerjes, ishte \$1 : 1.1 euro. Shkalla e këmbimit më 31/12/X1, data e pasqyrës së bilancit, është \$1 : 1.15 euro.

Në pasqyrën e bilancit të datës 31/12/X1, Importet e Kosovës do të vazhdojnë që të raportojnë një bilanc të stoqeve prej 11,000 eurove që kanë të bëjnë me këtë transakcion. Zërat jo monetarë që barten në koston historike, të atilla si stoqet, raportohen në pasqyrën e bilancit duke përdorur shkallën e pasqyrës së bilancit prej datës së transakcionit.

Zërat jo monetarë në vlerën fer

15. Përpunimi i raportimit të duhur për zërat jo monetarë që barten në vlerën fer është që t'i raportojë ata duke përdorur shkallën e këmbimit prej datës së transakcionit.

16. Në vijim është një ilustrim i balanceve të transaksioneve jo monetare në pasqyrën e bilancit kur zëri të raportohet në vlerën fer.

Kompania e Sigurimeve të Kosovës investoi në aksionet e zakonshme të një kompanie bullgare me një kosto prej 10,000 leva bullgare. Kompania e Sigurimeve të Kosovës i mirëmban regjistrat e saja të kontabilitetit në euro. Në përputhje me SKK 14, investimet e aksioneve është tregëtuar me koston fer të tregut më 1/12/X2². Shkalla e këmbimit më 1/9/X2, data e blerjes, ishte 1 euro : 1.9 leva. Shkalla e këmbimit më 1/12/X2, data e vlerësimi fer të tregut, ishte 1 euro : 2 leva.

²Kjo është një gjendje hipotetike e përdorur për qëllime të shpjegimit. Investimet e aksioneve janë të korigjuara për në vlerën fer të tregut në gjendjet ku ekziston një treg aktiv. Si është shënuar në SKK 14, kur informacioni në vlerën fer të tregut nuk është në dispozicion, investimet mirëmbahen duke përdorur metodat e koston historike.

Në pasqyrën e bilancit që daton më 31/12/X2, Kompania e Sigurimeve të Kosovës do të raportojë një balanc të investimeve prej 5,000 euro që kanë të bëjnë me këtë zë. Kjo vlerë llogaritet duke përdorur shkallën e aty për atyshme të më 1/12/X2. Zërat jo monetarë që barten në vlerësimin fer të tregut raportohen në pasqyrën e bilancit duke përdorur shkallën e këmbimit prej datës së vlerësimit të tregut.

Njohja e ndryshimeve të shkallëve të këmbimit

17. Ndryshimet e shkallëve të këmbimit që kanë të bëjnë me transaksionet e valutave të huaja duhet të njihen në pasqyrat financiare në dy gjendje. Nëse cilado prej të vijueshmeve ndodh si rezultat i ndryshimeve në shkallën e këmbimit që pason pas transaksionit fillestar, një fitim apo humbje nga këmbimi do të regjistrohet:

- ? Ndryshimet në balancet raportuese të zërave monetarë në datën e pasqyrës së bilancit
- ? Kryerja e transaksionit në shkallën e këmbimit është e ndryshme prej shkallës së këmbimit kur zëri është regjistruar fillimisht

18. Korigjimet në vlerat e pasqyrës së bilancit njihen si fitime apo humbje në pasqyrën e të ardhurave. Ndryshimet në shkallët e këmbimit do të njihen si të ardhura apo shpenzime në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodh korigjimi.

19. Ilustrime të njohjes së ndryshimeve të shkallëve të këmbimit.

Ilustrim # 1

Kompania e Importeve të Kosovës bleu stoqe prej Kooperatës së SHBA-ve më 1/12/X1 në çmimin e USD\$10,000. Importet e Kosovës e regjistrojnë një të pagueshme me datën e shitjes duke përdorur koston ekuivalente në dollarë amerikan USD. Është pra shuma e eurove që kërkohet në mënyrë që të këmbetet për 10,000 \$ amerikan me datën e transaksionit blerës. Shkalla e këmbimit më 1/12/X1, data e blerjes, ishte \$1 : 1.1 euro. Shkalla e këmbimit më 31/12/X1, me datën e pasqyrës së bilancit, është \$1 : 1.15 euro.

Blerja fillestare është regjistruar nga Importet e Kosovës në euro duke e rritur bilancin e stoqeve 11,000 dhe duke regjistruar një shumë të barabartë të kontove të pagueshme.

Në pasqyrën e bilancit të datës 31/12/X1, Importet e Kosovës do të raportojnë një bilanc të kontove të pagueshme prej 11,500 eurove që kanë të bëjnë me këtë zë. Është shuma e eurove që kërkohet më 31/12/X1 në mënyrë që të paguhet detyrimi prej USD\$10,000.

Transakcioni i korigjimit që duhet të regjistrohet në regjistrat e kontabilitetit të Importeve të Kosovës më 31/12/x1 në mënyrë të paraqitet në mënyrë korrekte shuma e detyrimit është:

Debia	Humbja në transakcionin me valutë të huaj	500
Kredia	Kontot e pagueshme	500

Më pas, në datën kur fatura ka qenë borxh dhe është paguar, korigjime të mëtutjeshme janë të nevojshme që ta reflektojnë koston ekuivalente në euro që të përmbush detyrimin. Për shembull, nëse fatura është paguar më 15/1/X3 dhe shkalla e aty për atyshme në atë ditë (lokale) është \$1 : 1.12 euro, Importet e Kosovës do të kenë nevojë për të paguar 11,200 euro në mënyrë që të paguajnë USD\$10,000 dhe ta paguajnë faturën siç kërkohet në USD (dollarë amerikan). Të pagueshmet që kanë të bëjnë me këtë transakcion e kanë një bilanc prej 11,500 euro, kështu që Importet e Kosovës duhet të bëjnë korigjimet në vijim që do të njohin një fitim prej 300 në transakcionet në valuta të huaja dhe të zvogëlojnë bilancin e kontove të pagueshme për 300.

Debia	Kontot e pagueshme	300
Kredia	Fitimi në transakcionin në valutë të huaj	300

Sipas këtij transakcioni, bilanci i kontos së pagueshme është 11,200 euro dhe Importet e Kosovës do të regjistrojnë pagesën e detyrimit duke eliminuar kontot e pagueshme prej 11,200.

Ilustrim #2

Kompania Eksportet e Kosovës i shesin mallëra një kompanie japoneze. Eksportet e Kosovës janë pajtuar që çmimi i shitjeve dhe i faturës do të emërtohet në jen. Çmimi i shitjes së mallërave është 1,500,000 jen.

Më 15/5/X1, datën e shitjes, shkalla e aty për atyshme ishte 1 euro : 75 jen

Më 15/7/X1, datën kur pagesa është paguar, shkalla e këmbimit të aty për atyshëm ishte 1 euro : 77 jen

Transakcioni i shitjes së datës 15/5/X2 regjistrohet në kontot në vijim të Eksporteve të Kosovës. Kjo është shuma që Eksportet e Kosovës do të pranenin në euro nëse pagesa prej 1,500,000 jen do të ishte pranuar dhe konvertuar në euro më 15/5/X2 .

Debia	Kontot e pranueshme	20,000
Kredia	Stoqet	20,000

Shuma e korigjuar e datës 15/7/X2 ishte regjistruar në kontot e vijueshme të Eksporteve të Kosovës. Kjo e korigjon bilancin në kontot e pranueshme për në

shumën që Eksportet e Kosovës do të pranojnë në euro kur të pranohet pagesa prej 1,500,000 jen dhe të këmbëhet në euro më 15/7/X2.

Debia	Humbja në transakcionin në valutë të huaj	519
Kredia	Kontot e pranueshme	519

Pranimi i pagesës më 15/7/X2 regjistrohet me sa vijon për Eksportet e Kosovës:

Debia	Pagesa e parave të gatshme	19,481
Kredit	Kontot e pranueshme	19,481

Trajtimi i kontabilitetit për operimet e huaja integrale në entitetin e raportimit

20. Pasqyrat financiare të operimeve të huaja që janë integrale për veprimet e ndërmarrjes raportuese duhet të përkthehen bazuar në premisën që ato janë, substantivisht, transaksione të vetë ndërmarrjes raportuese. Pranda, rregullat që gjenden në SKK 11, që kanë të bëjnë me raportimin e zërave të valutës së huaj në transaksionet e vetë ndërmarrjes, përgjithësisht do të vlejné për një veprim të tillë të huaj (SKK 11, paragrafi 7).

21. Shembuj të operimeve të huaja integrale në entitetin e raportimit
Eksportet e Kosovës e mirëmbajnë një zyrë të shitjeve në Londër. Zyra e shitjeve shet vetëm mallra që i pranon prej Eksporteve të Kosovës. Zyra e shitjeve i dërgon paratë nga shitjet drejtpërdrejtë tek zyra kryesore e Kompanisë së Eksporteve të Kosovës e vendosur në Prishtinë.

Zyra e shitjeve të huaja i mbledh pagesat në sterlinga britaneze dhe Kompania e Eksporteve të Kosovës e përdor shkallën e këmbimit të aty për atyshme prej datës së shitjes që të regjistroj transakcionin e shitjes në regjistrat e kontabilitetit. Supozimi është që të trajtohen transaksionet e shitjes sikur të ndërmarrja raportuese të ishte futur në secilin transakcion të operimeve të huaja.